

ARTAN R. HOXHA

**LIDHJA E PRIZRENIT DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE
GJATË VITEVE 1878-1881
NË DOKUMENTET AMERIKANE**

Lidhja Shqiptare e Prizrenit përbën një çast kulmor të historisë së shqiptarëve, si e tillë trajtimi i saj ka gjetur vend të gjerë në historiografinë shqiptare dhe jo rrallë edhe në atë të huaj. Natyrshëm punimet e deritanishme, në pjesën më të madhe të tyre, kanë shfrytëzuar burime arkivore osmane, të shteteve ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha europiane. Në të vërtetë kjo nuk mund të quhet kurrësesi një dobësi, pasi pikërisht këto shtete kanë qenë të interesuara për çështjen shqiptare. Megjithatë jemi të mendimit që për të kuptuar më mirë zhvillimet e ngjarjeve në atë kohë në trevat shqiptare, si dhe për të rrokur në mënyrë më të plotë arsyet e politikës së Koncertit European ndaj Çështjes Shqiptare duhen shfrytëzuar edhe burime arkivore nga fuqi jo të interesuara ndaj problemit shqiptar. Me vlerë paraqiten veçanërisht burimet arkivore amerikane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për nga vetë largësia prej Europës dhe politikës së jashtme që ato ndiqnin, ishin krejtësisht të shkëputura dhe të paimteresuara ndaj asaj çka ngjante në Europë. Për këtë arsye, burimet arkivore amerikane paraqesin mjaft interes pasi ato, në krahasim me burimet arkivore europiane, janë më të prirura për të qenë objektive. Veç kësaj, qëndrimi moralist që mbanin amerikanët ndaj zhvillimeve ndërkombëtare na ndihmon më tej për të kuptuar politikën e Fuqive të Mëdha të Kontinentit të Vjetër dhe raportin që qëndronte mes tyre dhe lëvizjeve kombëtare në Europë.

Deri më tani nuk ka patur asnjë punim që të trajtojë këndvështrimin zyrtar amerikan mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Dokumentat amerikanë, mbi problemin që na intereson, nuk janë të shumtë dhe vetëm në pak raste ato i janë kushtuar tërësisht ngjarjeve që zhvilloheshin në atë kohë në Shqipëri. Sidoqoftë ato janë të mjaftueshme për të dhënë një panoramë deri diku të plotë mbi qëndrimin amerikan ndaj Çështjes Shqiptare. Për të kuptuar më mirë diplomacinë amerikane dhe politikën e saj ndaj problemeve europiane, kemi shfrytëzuar edhe një varg burimesh sekondare që flasin mbi shtyllat kryesore që udhëhiqnin qëndrimin e Departamentit të Shtetit Amerikan dhe politikave të tij botërore. Nga vëzhgimet dhe analizat e bëra është vënë re gjithashtu një lidhje shumë e madhe mes qëndrimit të shtypit amerikan dhe diplomacisë amerikane, për këtë arsye kemi shfrytëzuar edhe organe të shtypit të përditshëm,

veçanërisht *New York Times*, një nga gazetatat më me ndikim në formësimin e opinionit publik amerikan. Por ndikim ka patur edhe shtypi evropian, i cili në fund të fundit i jepte opinionit publik në ShBA modelet përmes të cilave të interpretonte ngjarjet dhe zhvillimet në vise mbi të cilat amerikanët kishin njohuri fare të pakta. Kaq i madh ishte ndikimi i shtypit evropian sa që shpesh ai dërgohej prej diplomatëve amerikanë në Europë si pjesë e raporteve të tyre në Uashington.

Por nga ana tjetër, shtypi jo gjithmonë ishte objektiv. Në mjaft raste ai qe kapriçoz dhe i binte borive për njëren palë, të cilën e simpatizonte apo kishte interesa, në dëm të një pale tjetër. Ky qëndrim vihej re edhe në marrëdhënie me popullsitë myslymane dhe ato të krishtera të Perandorisë Osmane. Europa e krishterë ishte më tepër e ndjeshme ndaj fatit të popullsisë të krishtera të rajonit se sa ndaj atyre myslymane. Kështu p.sh. në rastin e krizës bullgare të vitit 1876, masakrave të kryera prej osmanëve u bëhej një bujë jashtëzakonisht e madhe, ndërsa masakrave të të krishterëve kundër myslymanëve u rezervohesh një vend mjaft i kufizuar.¹ Një qëndrim i ngjashëm do të vihej re edhe karshi shqiptarëve, të cilët në shumicën e tyre ishin myslymanë. Këtë do ta vinte në dukje dekada më vonë edhe Edith Durham, e cila ankohej se sa herë që shqiptari plaçkiste apo digjte ndonjë fshat serb, për Europën kjo përbënte ‘barbari’² ndërkohë që masakrat e panumërta të kryera kundër shqiptarëve prej fqinjëve të vet kalonin krejt në heshtje, e madje në Europë, ata që i kryenin ato, quheshin patriotë.³ Për rrjedhim, në kushtet kur objektiviteti i shtypit evropian mbi zhvillimet në Ballkan ishte shumë i dyshimtë, atëherë edhe informacioni që merrnin kancelaritë diplomatike, të cilat e përdornin shtypin si burim të dhënash apo si model qëndrimesh, ishte shpesh i shtrembëruar dhe i pasaktë.

Varësia e qëndrimit të diplomatëve ndaj klisheve që prodhonte shtypi ishte e dyanëshme, pasi ai nuk ndikonte mbi ta vetëm si një mjet shtrëngues që i detyronte ata të merrnin vendime të padëshiruara, por ai krijonte dhe sendëronte në mjaft raste edhe konceptet e tyre. Ky pohim vlen edhe në rastin e mendimit që krijonte ndonjë diplomat amerikan mbi shqiptarët. Kështu, në një raport që Ministri amerikan në Romë, George P. Marsh (Xhorxh Marsh), i dërgonte Sekretarit të Shtetit, William Maxwell Evarts (Uilliam Maksuell Ivërts), në korrik të vitit 1878, ndërsa i fliste për shqiptarët, i cilësonte ata si ‘të dhunshëm’, ‘gjakatar’ dhe ‘gjysëm-barbar të paqeverishëm.’⁴ Por ky nuk mund

¹ George Gawrich, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja*, Tiranë: “Bota Shqiptare”, 2007, f. 57.

² Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1990.

³ *Po aty*, f. 43.

⁴ *FRUS 1878-1879*, vëll. I, Washington: “Government Printing Office”, 1879, f. 476.

të jetë një përfundim përgjithësues, pasi nuk mund të thuhet se mendimi që kishin diplomatët amerikanë në Europë mbi Shqipërinë përcaktohej nga shtypi i vendeve ku ata shërbenin. Në fakt, nuk mund të mohohet se niveli i zhvillimit të shoqërisë shqiptare të asaj kohe ishte larg atij europian, e për rrjedhim mjaft prej vlerësimeve që bëheshin, në shumë raste qëndronin pranë së vërtetës dhe i përgjigjeshin realitetit shqiptar. Ndërkohë tezat e sipërpërmendura nuk qarkullonin vetëm në shtyp. Në kuadrin e lulëzimit të orientalizmit, mjaft prej këtyre paragjykimeve ishin teza të pranuar gjerësisht si të vërteta për të gjitha shoqëritë që cilësoheshin si lindore, dhe si të tilla vlerësoheshin edhe shqiptarët. Nga ana tjetër nuk mund të mbivlerësohet rëndësia e shtypit, i cili nuk përbënte të vetmin burim informacioni për trupin diplomatik amerikan në Europë, por vetëm njërin prej këtyre burimeve. Gjithashtu, sikurse do të shohim edhe më tej, mendimi i diplomatëve amerikanë shpesh binte ndesh me atë të shprehur në gazetatat europiane apo me atë çka thoshin kancelaritet e Fuqive të Mëdha europiane. Secili prej tyre kishte një gjykim të vetin të veçantë, i cili në raste të caktuara puqej me atë europian. Në këtë studim, duke parashtuar njëherësh përmbajtjen e artikujve që diplomatët i dërgonin Uashingtonit dhe analizat që ata bënin në raportet e tyre mbi ngjarjet në Shqipëri, do të bëhet një ballafaqim mes tyre, si dhe do të gjykohen pikat e takimit dhe të ndarjes. Në këtë mënyrë do të kuptohet edhe shkalla e varësisë së qëndrimit amerikan prej atij europian ndaj Çështjes Shqiptare.

Ngjarjet që zhvilloheshin gjatë kësaj kohe në Shqipëri zinin një vend të përkorë në raportet e përfaqësuesve diplomatik amerikan në Europë. Në përgjithësi ajo përmendet përciptasi dhe pothuaj në të gjitha rastet në kuadrin e përgjithëshëm të 'Çështjes Lindore'. Shkaqet e këtij mosinteresi dhe mungese të njohurive prej diplomatëve amerikanë ndaj Shqipërië dhe rajonit ka një varg arsyeshe objektive dhe subjektive, të cilat në disa raste kanë lidhje të ndërsjellta me njëra-tjetrën. Nëse e nisim shpjegimin nga këto të fundit, pra nga arsyet subjektive, një nga to është niveli i ulët i shërbimit diplomatik amerikan i kohës.⁵ Por kjo arsye nuk mund të qëndroje e vetme. Shpjegimi gjendet edhe te vellua e misterit që mbulonte Shqipërinë. Në fakt, Shqipëria ishte një *terra incognita* për Europën, përfshi këtu edhe shtypin e kontinentit të vjetër, e për rrjedhim të dhënat mbi të ishin tepër të kufizuara. Këtë e pranon me gojën e vet njëri prej diplomatëve më të rëndësishëm amerikanë në Europë. Kështu në një rast, Ministri amerikan në Vjenë, John A. Kasson (Xhon Kason), do të ankohej se informimi mbi ngjarjet në Shqipëri pamundësohej nga mungesa e shtypit në vend dhe e korrespondentëve, nga qenia e vendit jashtë rrugëve në të cilat

⁵ David M. Pletcher, "Growth and Diplomatic adjustment", në *Economics & World Power. An assessment of American diplomacy since 1789*, botuar nga William H. Becker, Samuel F. Wells, Jr., New York: "Columbia University Press", 1984, f. 128-129.

udhëtonin të huajt, si dhe nga prania vetëm e të dërguarve diplomatik.⁶ Por Shqipëria nuk ishte e vetme. Kjo ishte një sindromë, e cila vlente edhe për vende të tjera të Ballkanit. Për shembull në një rast tjetër, po Kason, na bën me dije se pas një udhëtimit që ai bëri në kufirin jugor të mbretërisë së dyfishtë, vendosi të vizitonte edhe Malin e Zi, meqënëse dinte fare pak rreth tij.⁷

Por shpërfillja ndaj ngjarjeve në Shqipëri e kishte burimin edhe në Uashington. Duke nisur që nga krijimi i vet ShBA-së dhe përgjatë shekullit XIX, Uashingtoni zyrtar shfaqti një ngurrim të vazhdueshëm ndaj përfshirjes në çështjet europiane. Mbi të gjitha, amerikanët shfaqnin një xheloz të skajshme, e cila shkonte deri në histori, ndaj ndërhyrjes europiane në hemisferën perëndimore. Fanatikë ndaj lirisë dhe pavarësisë së tyre dhe ndaj asaj pjese të botës që ata e quanin si zonën e natyrshme të ndikimit të vet, amerikanët i kishin treguar dhëmbët fuqive europiane, që kërkonin të shtrinin zonat e tyre të ndikimit në cilën çdo pikë të të dy kontinentet amerikanë. Ky ishte edhe thelbi i Doktrinës Monro, e cila u bë publike nga presidenti amerikan me të njëjtin emër, në dhjetor të vitit 1823.⁸ Në këtë kuadër, Lindja e Afërme, term ky që përfaqësonte në atë kohë rajonin ku bënë pjesë edhe trevat shqiptare, zinte një vend krejt anësor në politikën e jashtme amerikane, pasi këtu tregtia dhe investimet amerikane ishin të papërfillshme dhe për rrjedhim interesat ekonomike amerikane liheshin në hije nga ato të fuqive europiane. Në kushtet kur boshti udhëheqës i diplomacisë amerikane që përcaktonte marrëdhëniet e ShBA-së me Europën ishte mbrojtja e interesave ekonomike dhe shtetasve amerikanë, atëherë diplomacia amerikane lihej krejt në hije dhe pesha e saj ishte krejt e papërfillshme për ngjarjet që zinin vend në Kontinentin Plakë.⁹ Përveç kësaj, pas Luftës Civile amerikane dhe punës së jashtëzakonëshme për rindërtimin e vendit, amerikanët dalloheshin nga një shpërfillje e pabesueshme ndaj asaj çka ndodhte jashtë vendit, në botë.¹⁰ Si rrjedhim, në këtë rast, në kushtet kur ngjarjet zinin vend në një rajon që ndodhej tej periferisë së interesave amerikane, Departamenti i Shtetit mbajti një qëndrim kundruës, duke u mjaftuar vetëm me të dhënat që i dërgonin përfaqësuesit e tij në vendet e përfshira në këtë krizë.

⁶ *FRUS 1880-1881*, vëll. I, Washington: "Government Printing Office", 1881, f. 54.

⁷ *Po aty*, f.60.

⁸ Për më tepër shih Kinley J. Brauer, "Economics and the Diplomacy of American Expansionism", në: *Economics & World Power. An assessment of American diplomacy since 1789*, botuar nga William H. Becker, Samuel F. Wells, Jr., New York: "Columbia University Press", 1984, f. 55-118.

⁹ David M. Pletcher, *art. i cit.*, f. 163.

¹⁰ Thomas A. Bailey, David M. Kennedy, *The American Pageant*, Lexington: "Heath and Company", 1983, f. 560.

Këta dërgonin rregullisht të dhëna mbi ecurinë e luftimeve dhe mbi lëvizjet diplomatike në kontinentin e vjetër. Në këtë kuadër përmenden edhe trojet shqiptare që u bënë shesh beteje mes ushtrive osmane dhe atyre malazeze, pas futjes së mbretërisë së vogël malore në këtë luftë përkrah gjigandit sllav.¹¹ Pas rënies së fortesës së Plevnës, përparimi i pandalshëm i ushtrive ruse e bëri të qartë për të gjithë opinionin publik perëndimor se fundi i luftës ishte i afërt dhe se disfata e plotë osmane që e pashmangshme. Këtë opinion ia përcolli Departamentit të Shtetit, Ministri amerikan në Londër, Edward Pierrepont (Eduard Pierpont), i cili i dërgoi Washingtonit një artikull të datës 5 dhjetor 1877, të gazetës së njohur britanike *London Times*, që sipas tij shprehte ndjenjat dhe mendimin britanik rreth ‘Çështjes Lindore’.¹² Në këtë artikull, ndërsa theksohej se largimi i otomanëve prej Europës ishte i paracaktuar, bëhej një parakalim mbi qëndrimin e të gjitha fuqive europiane ndaj kësaj çështje. Sipas këtij artikulli, shumica e opinionit publik dhe segmenteve politike në secilën prej fuqive kryesore europiane mbante një qëndrim të vendosur antiosman. Aty, teksa vihej në dukje rëndësia e qëndrimit britanik, i bëhej thirrje diplomacisë angleze që të bashkohej me korin e fuqive kontinentale dhe të hiqte dorë nga cinizmi i dëshmuar deri në të çast prej saj.¹³ Rënia e Perandorisë Osmane, tërheqja e saj nga Europa dhe turrja deri në Stamboll, do të sillte paqen e shumë dëshiruar dhe do të lejonte emancipimin e popujve të shtypur prej prej shekujsh.¹⁴ Interesant është fakti se ndërsa flitet për popujt ballkanik, aty përmenden sllavët dhe grekët, por jo shqiptarët. Po aq interesant është edhe fakti tjetër se tezat e ngritura në këtë artikull të gazetës së njohur britanike u hodhën poshtë prej një artikulli, të njëjës prej gazetave më të mëdha amerikane. Sipas këndvështrimit amerikan, nuk ishte cungimi ilaçi i shërimit që do të sillte paqen në Europë, por natyra e keqeverisjes osmane. Ishte pikërisht ndreqja e kësaj të fundit që do të përmirësonte gjendjen e popujve që ndodheshin nën sundimin e saj dhe do të sillte për rrjedhim paqen.¹⁵ Sikurse edhe vihet re, këtu kemi përplasjen mes dy koncepteve, atij amerikan nga njëra anë, i cili mbështetej mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje, i cili shprehej para së gjithash në mirëqeverisjen e tyre, dhe atij imperialist britanik e europian, i cili, ndërsa tundte flamurin e shtet-kombit, hiqte vija kufijsh sipas interesave të ngushta gjeostrategjike dhe ekonomike, pa përfillur aspak dëshirën e kombeve mbi të cilat kalonin këta kufijë.

¹¹ *FRUS 1877-1878*, vëll. I, Washington: “Government Printing Office”, 1878, f. 604.

¹² *Po aty*, f. 239.

¹³ *Po aty*, f. 240.

¹⁴ *Po aty*, f. 241.

¹⁵ “Dobitë e pushtimit”, *New York Times*, 10 mars 1878.

Në kuadrin e informacioneve të rregullta që dërgoheshin mbi zhvillimet e Krizës Lindore, Ministri amerikan në Berlin, Sidney Everret (Sidni Ivëret), i dërgoi Departamentit të Shtetit fjalimin që mbajti kancelari gjerman, princi Otto von Bismarck (Oto fon Bismark), në Rajhshtag në lidhje me mbajtjen e konferencës që do të rishqyronte Traktatin e Shën Stefanit. Në këtë fjalim Bismarku teksa parashtronte gjendjen e përgjithshme në marrëdhëniet mes fuqive europiane dhe jepte shkurtimisht ndryshimet territoriale që prodhonte Traktati i Shën Stefanit, përmendte shkarazi edhe shqiptarët. Teksa fliste për kufijtë perëndimorë të shtetit bullgar, që dilnin prej traktatit të sipërpërmendur, kancelari gjerman pranonte mospërputhjen në këtë pikë të kufijve shtetërorë me ata etnikë, pasi kufijtë e shtetit të ri bullgar shtriheshin pak përtej kufijve etnikë, pasi futeshin në rajone që banoheshin prej racave shqiptare.¹⁶

Por ky pohim i kancelarit gjerman nuk ndahej prej ndonjë diplomati amerikan. Kështu, në një raport që i dërgonte Departamentit të Shtetit në tetor të vitit 1878 mbi gjendjen në Bullgari, Ministri amerikan në Stamboll, Horace Maynard (Horas Mejnard), teksa fliste për kufijtë që shteti bullgar do të kishte patur nga Traktati i Shën Stefanit, pohon se kufijtë e tij do të shtriheshin “nga Danubi në Egje, dhe do të përfshinte afërsisht gjithë territoret ku shumica e popullsisë ishte bullgare...”¹⁷. Por ky qëndrim i tij udhëhiqej edhe nga simpatia që ai ushqente ndaj bullgarëve, e cila diktohej edhe nga veprimtaria e misioneve amerikane. Kjo duket në të njëjtin dokument, ku ai flet edhe për punën e madhe të kryer prej misioneve amerikane në Bullgari dhe përkrahjen e zjarrtë që kishin gjetur misionarët amerikanë te bullgarët.¹⁸

Sikurse shihet, hapja e vendeve ballkanike ndaj misioneve amerikane ka luajtur një rol të madh në njohjen e këtyre vendeve në ShBA dhe në mbështetjen e çështjes kombëtare dhe interesave të tyre prej diplomatëve amerikanë. Fakti se Shqipëria ishte relativisht e paarritëshme për të huajt, përfshi këtu edhe amerikanët, e linte atë krejtësisht të panjohur. Për rrjedhim, shqiptarët e kishin shumë të vështirë të gjenin një mbështetje morale, politike dhe materiale në Europë dhe Amerikë. Ndërkohë, sikurse e pamë edhe më sipër, kjo nuk vlente për fqinjët tanë, të cilët gjenin jo pak mbështetje në të mirë të përmbushjes së programeve të tyre kombëtare. Shqipëria ishte, po të përdorim thënien e bujshme të Bismarkut, një nga ato vende, emrin e të cilave askush nuk e kishte dëgjuar para luftës ruso-turke.

Ndërkohë, Ministri amerikan në Londër, John Welsh (Xhon Uellsh), lajmëronte Sekretarin e Shtetit, Evarts, se, si pasojë e marrëdhënieve tejet të tendosura anglo-ruse, në Europë mbizotëronte një atmosferë e rënduar, aq sa

¹⁶ *FRUS 1877-1878...*, vëll. I, f. 196.

¹⁷ *FRUS 1878-1879...*, vëll. I, f. 913.

¹⁸ *Po aty*.

besohej gjerësisht në një luftë mes këtyre dy fuqive.¹⁹ Në këtë raport, ai i dërgonte Evarts-it edhe mesazhin e Sekretarit për marrëdhëniet me jashtë të Madhërisë së Saj, markezit Salisbury (Salzbëri), lidhur me çështjen e Turqisë, në të cilën ai, teksa analizon Traktatin e Shën Stefanit, flet për ngritjen e shtetit bullgar, që përbënte edhe shqetësimin kryesor të britanikëve. Sekretari britanik e quante të padrejtë shtrirjen e këtij shteti, pasi sipas tij ai përfshinte brenda kufijve të vet edhe popullsi greke, e cila e shikonte me shqetësim përfshirjen e saj brenda këtij shteti të madh sllav. Përveç kësaj, kushtet e vëna nga rusët në këtë traktat, të cilat e shtrinin ndikimin e tyre përtej kufijve bullgar, më saktë në Thesali dhe Epir, sipas markezit nuk mund të mos shiheshin me shqetësim prej Portës së Lartë dhe qeverisë greke, si dhe prej fuqive që kishin interesa në Perandorinë Osmane dhe në Mesdhe.²⁰ Krijimi i këtij shteti të madh bullgar, shtonte Salzbëri, do të krijonte për Stambollin mjaft vështirësi për administrimin e provincave shqiptare greke dhe sllave, të cilat do të shkëputeshin prej tij, do ta dobësonte Portën e Lartë dhe kështu popullsia e këtyre provincave do të ballafaqohej në mënyrë të pandërprerë me rrezikun e anarkisë.²¹ Sikurse shihet, shqiptarët nuk përmenden gjëkund, dhe dëshirat e tyre dhe kërkesat e tyre, ose binin në vesh të shurdhër, ose as që nuk arrinin të dëgjoreshin.

E menjëherëshme ishte përgjigja ruse ndaj mesazhit të markezit Salzbëri. Në një qarkore, kancelari i Perandorisë Ruse, Princi Gorçakov, replikonte me Sekretarin britanik mbi pikëpamjet e ngritura prej këtij të fundit mbi çështjen e Turqisë dhe politikën ruse në Europën Juglindore, të cilat u shprehën më mirë se kudo në Traktatin e Shën Stefanit. Sipas Gorçakovit, përcaktimi i kufijve të Bullgarisë u krye duke u mbështetur vetëm në parimin e shumicës së popullsisë.²² Gjithashtu, padisë së kreut të diplomacisë britanike, se Rusia me anë të Traktatit të Shën Stefanit kërkonte të shtrinte ndikimin e saj edhe në Thesali dhe Epir, Kancelari rus i përgjigjej se kabineti perandorak carist duke e patur të qartë misionin historik që i ishte caktuar Ruisë në Lindje, në një kuptim të krishterë, për të çliruar të gjitha racat pa dallim feje dhe besimi.²³ Parë nga ky vështrim, kushtet e vëna Portës së Lartë prej Ruisë në Traktatin e shumëpërfolur, kishin vetëm qëllimin e përmirësimit të institucioneve që vepronin në ato që Gorçakovi i quante provinca greke.²⁴

Vendimet e Kongresit të Berlinit i lanë të pakënaqur si Perandorinë Osmane, ashtu edhe shtetet ballkanike. Por pati zhurmë se edhe Italia ushqente

¹⁹ *Po aty*, f. 259-260.

²⁰ *Po aty*, f. 262-263.

²¹ *Po aty*, f. 263.

²² *Po aty*, f. 878.

²³ *Po aty*, f. 879.

²⁴ *Po aty*.

pakënaqësi kundrejt vendimeve të marra në këtë kongres. Delegacioni italian, që drejtohej nga konti Korti, u kthye në atdhe pa asnjë trofe, e për këtë arsye u godit me gurë nga bashkatdhetarët e vet të revoltuar.²⁵ Por zërat që mëtonin se turmat e irrituara përfaqësonin opinionin e përgjithshëm në Itali, iu përgënjeshtroan Departamentit të Shtetit prej Ministrit amerikan në Itali, George P. Marsh (Xhorxh Mersh). Sipas diplomatit amerikan, çdo kërkesë e italianëve për t'u kompensuar për aneksimin Bosnjes dhe Hercegovinës prej Austro-Hungarisë, me treva në bregun lindor të Adriatikut nuk do të kishte gjetur mbështetje nga Kongresi i Berlinit. Përkundrazi, një kërkesë e tillë do të kishte pasur si frut të vetëm armiqësimin e Italisë me mbretërinë e dyfishtë. Marsh, e quante të pavend aneksimin e trojeve shqiptare prej Italisë, duke u nisur edhe nga gjendja e brendshme shoqërore, ekonomike dhe politike e kësaj të fundit. Sipas tij, ndërsa Italia nuk ishte e zonja të garantonte sigurinë e jetës dhe pronës brenda kufijve të saj egzistues, aneksimi prej saj i trevave ku jetonte një popullsi e përbërë prej disa qindra mijëra gjysëm-barbarësh gjakatarë, të dhunshëm dhe të paqeverisshëm, do të rëndonte edhe më tej situatën aspak të pëlqyeshme në të cilën ndodhej vendi. Për rrjedhojë, përfaqësuesi diplomatik amerikan ishte i mendimit se pakënaqësia politike që egzistonte në atë kohë në Itali, nuk ishte pasojë e mosaneksimit të Shqipërisë apo trevave të tjera të Perandorisë Osmane.²⁶

Ndërkaq, Kongresi i Berlinit vlerësohej prej Ministrit amerikan në Stamboll, Horas Mejnard, si aspak i suksesshëm. Duke i bërë një analizë me frymë antiimperialiste, ai nënvizonte së pavarësisht faktit se ishte shmangur një luftë mes Britanisë së Madhe dhe Ruisë, vendimet e tij nuk lejonin rivendosjen e paqes në Lindje. Ai përdorte si provë për këtë vlerësim të tijin trazirat në të gjithë provincat, të cilat sipas vendimeve të kongresit në fjalë, duhej t'i kalonin shteteve të tjera.²⁷ Mejnard, njoftonte Departamentin e Shtetit se në Stamboll qarkullonin dyshime se Porta ishte duke inkurajuar këtë qëndresë kundër vendimeve të kongresit, por ai theksonte se nuk kishte parë asgjë që të vërtetonte dyshime të tilla. Sipas tij kjo qëndresë shpjegohej me gjendjen shpirtërore të popujve, të cilët kërkonin pavarësinë dhe jo thjesht ndërrimin e zotnive.²⁸ Ky pohim i diplomatit amerikan do të vërtetohej me vrasjen e Mehmet Ali Pashës në Gjakovë.

Sipas Mejnardit, kjo ngjarje bëri mjaft bujë dhe për të u shkruajt gjerësisht në shtypin europian. Në mënyrë që në Departamentin e Shtetit të informoheshin më mirë për këtë ngjarje, ai dërgoi një artikull të botuar në

²⁵ Norman Rich, *Diplomacia e fuqive të mëdha, 1814-1914*, Tiranë: "Toena & IDK", 2006, f. 227.

²⁶ *FRUS 1878-1879...*, vëll. I, f. 475-476.

²⁷ *Po aty*, f. 894.

²⁸ *Po aty*, f. 890-891.

gazetën *Pall Mall Gazete*, që sipas gjykimit të tij, ishte ndër më objektivet.²⁹ Në këtë artikull flitet edhe për themelimin e Lidhjes, e cila, sipas autorit të tij, u krijua si kundërpërgjigje e banorëve të Bosnjes së Jugut, veçanërisht shqiptarëve gegë, të cilët, në kushtet ku Porta e Lartë ishte e paaftë, u ngritën e rrëmbyen armët për të mos lejuar kalimin e këtyre trevave në duart e fuqive të tjera.³⁰ Sikurse shihet, padija e autorit mbi ndarjet gjeografike, etnografinë dhe demografinë e rajonit vërtetohen gjatë gjithë gjatësisë së këtij pohimi. Megjithatë, në të pohohet se kjo lëvizje e kishte truallin e vet në popullsinë e rajoneve që rrezikoheshin të aneksoheshin dhe jo thjesht te urdhrat e Stambollit, pohim ky që ecën në unison me mendimin që kishte shprehur më parë diplomati amerikan.

Përsa i përket vrasjes së Mehmet Aliut, edhe këtu jepen lajme të pambështetura dhe krejt të pavërteta, si p.sh. kur jepet shifra e ekzagjeruar për popullsinë e Gjakovës, për të cilën thuhej se banohej edhe prej 16000 myslymanësh, apo kur jepet si një nga arsytet e vrasjes së Mehmet Aliut, fakti se gjakovarët kujtuan se ai ishte hungarez. Përveç kësaj në artikull përshkruhet mënyra barbare e vrasjes dhe masakrimin të kufomës së Mehmet Aliu dhe mikpritësit të tij Abdullah pashës, lajm ky që i nxirrte shqiptarët si egërsira të paqytetëruara, duke dëmtuar kështu shumë imazhin e Lidhjes Shqiptare.³¹

Prej këtij çasti, pra nga shtatori i vitit 1878, ngjarjet në Shqipërinë e Veriut dhe veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit në këtë rajon nuk përmenden më në dokumentat amerikanë për më shumë se 19 muaj. Shkaqet e këtij hiatusi në dokumentacion mund të jenë të shumta. Ato shtrihen nga mungesa e interesit të diplomatëve amerikanë për të raportuar zhvillimet në malësitë e veriut shqiptar e deri te mungesa e informacionit mbi atë çka ngjante aty. Ashtu sikurse do të pohonte Ministri amerikan në Vjenë, Xhon Kason, mungesa e shtypit në vend dhe e korrespondentëve, qenia përtej kufirit të udhëtimeve të të huajve, dhe prania vetëm e të dërguarve diplomatik, e bënë të pamundur informimin mbi lëvizjet popullore dhe zhvillimet ushtarake që ngjanin në vend.³² Por në këtë dokument tejet të rëndësishëm, ai lë të kuptojë se ka qenë në dijeni të përpjekjeve të shqiptarëve për të mbrojtur tërësinë e tyre tokësore. Kështu në 5 maj të vitit 1880, Kason, lajmëronte Departamentin e Shtetit, se gjendja në kufirin shqiptaro-malazet kishte tërhequr sërish vëmendjen në qeverinë e mbretërisë së dyfishtë dhe theksonte se ajo kishte ngjallur ankth.³³ Në këtë periudhë Lidhja Shqiptare kishte filluar të organizonte mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, pas dështimit të malazezëve për të marrë Plavën dhe Gucinë. Pikërisht,

²⁹ *Po aty*, f. 895.

³⁰ *Po aty*, f. 908.

³¹ *Po aty*, f. 909.

³² *FRUS 1880-1881...*, vëll. I, f. 54.

³³ *Po aty*.

që përpjekjet e përgjakëshme mes shqiptarëve dhe ushtrive malazeze për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë nuk kishin kaluar të pavëzhguara, duket kur Kason theksonte se këmbngulja shqiptare për të hedhur poshtë planin Korti, po shkaktonte sërish ankth dhe shqetësim. Veç kësaj Ministri amerikan i kujton Sekretarit të Shtetit, Evarts, se ky i fundit kishte dijeni mbi ndërhyrjen e kontit Korti për të zëvendësuar territorin e mbrojtur fillimisht nga shqiptarët me territore të reja, pra që malazetët në vend të Plavës dhe Gucisë të merrnin Hotin dhe Grudën.

Diplomacia amerikane e kishte kuptuar se tashmë shqiptarët ishin kthyer tashmë në një faktor të rëndësishëm në lojën ndërkombëtare. Gjatë këtij hiatusi dokumentar, mendimi i diplomatëve amerikanë mbi natyrën nacionaliste të Lidhjes Shqiptare u përforcua edhe më tej. Qëndrimi i vendosur nationalist i krerëve të Lidhjes dhe kundërshtimi prej tyre i urdhrave të Portës së Lartë kishin shpëlarë çdo lloj dyshimi që mund të ushqenin diplomatët amerikanë mbi natyrën e lëvizjes shqiptare. Një tjetër konstatim i rëndësishëm është fakti se këto raporte vinin prej Austro-Hungarisë dhe jo prej Stambollit, i cili ishte i përfshirë drejtëpërdrejtë në këto zhvillime. Ky fakt na shtyn të dalim në përfundimin se në Stamboll, trupi diplomatik mbahej në hije të zhvillimeve që ishin duke ngjarë në kufijtë perëndimorë të perandorisë.

Në këtë raport diplomati amerikan i dërgonte Departamentit të Shtetit edhe një shpallje, e cila sipas tij ishte shenjë që shqiptarët ishin duke u shtyrë drejt pavarësisë. Kason i sheh shqiptarët si një faktor të ri dhe të rëndësishëm për ndreqjet territoriale dhe qeverisëse në Turqinë europiane, e cila ishte kthyer në një enë që ziente nga aspiratat që binin ndesh mes kombësive të ndryshme, të cilat nga ana e tyre kishin si armik të përbashkët autoritetin osman dhe që ndërkohë kërkonin pavarësi lokale dhe bashkim kombëtar.³⁴

Një javë më vonë, i njëjti diplomat, i dërgon Departamentit të Shtetit një raport të dytë ku e lajmëron atë mbi ngjarjet në Shqipëri. Në fakt këto janë dy dokumentet e vetme që i dërgohen Uashingtonit duke patur si subjekt të vetëm Shqipërinë dhe zhvillimet që kishin zënë vend në të. Sipas Kasonit, në Adriatikun lindor po grumbulloheshin retë e luftës, të cilat mund të shkaktonin trazira edhe në pjesën austriake. Ai nënvizon se shqiptarët nuk kanë rrëmbyer armët vetëm për të mbrojtur një rrip toke. Por ata, shton ai, kanë marrë në duart e veta fatin e tyre kombëtar dhe kanë shpallur pavarësinë e racës dhe territorit të tyre kundër të gjithë të ardhurve. Kason vë në dukje se gjurmimi i rrjedhës së ngjarjeve ishte mjaft i vështirë si pasojë e komunikimit fare të ulët të Shqipërisë me botën.³⁵ Në këtë dokument raportohet bashkimi i myslimanëve me katolikët, gjë që u shpreh në vendosjen e dy komandantëve ushtarak që do të organizonin

³⁴ *Po aty*, f. 55.

³⁵ *Po aty*.

mbrojtjen, të cilët ishin Prenk Bib Doda dhe Hodo Beu.³⁶ Departamenti i Shtetit lajmërohet se Lidhja kishte shpallur shkëputjen prej sundimit të sulltanit si edhe për masat kryesore të marrë prej saj siç ishte shkarkimi i të gjithë zyrtarëve që nuk kishin kombësi shqiptare, zënia e zyrave publike prej Lidhjes dhe shndërrimin e saj në të vetmin organ prej të cilit populli shqiptar mund të merrte urdhra.³⁷

Pas parashtrimit të këtyre njoftimeve, Kasoni, del në përfundimin se këto lajme që po i raportonte Departamentit të Shtetit dukeshin të ishin autentike dhe ato ishin rrjedhoja llogjike e ngjarjeve të mëparëshme. Sipas tij, kjo lëvizje nuk duhej parë si një nga kryengritjet e shumta që shpërthenin herë pas here në Perandorinë Osmane kundër sundimit të Portës së Lartë, por, mendonte diplomati amerikan, shpalljet e bëra nga Lidhja tregonin qartë se udhëheqësit shqiptarë e vlerësonin me mjaft realizëm gjendjen e tyre të pashpresë politike. Shqiptarët, shton ai, ndërsa kanë parë se si janë realizuar aspiratat e popujve të tjerë të Ballkanit, që kanë formuar shtetet e tyre kombëtare, kanë përjetuar shpërfilljen që është treguar ndaj tyre, e madje treva të tyre në veri u janë dorëzuar Malit të Zi dhe në jug i janë dorëzuar Greqisë. Porta, e gjendur mes vështirësive financiare, komplotoi me shqiptarët dhe i mbështeti ata që t'i bënin qëndrësë vendimeve të kongresit. Por tashmë, përballë dobësisë osmane, dhe presionit europian për t'i dorëzuar trojet e premtuara Greqisë dhe Malit të Zi, Lidhja Shqiptare i ka kthyer armët kundër vetë Portës dhe përmes veprimeve të veta kërkon të provojë se Turqia është e paafte të zbatojë vendimet e Fuqive të Mëdha. Ndryshe nga ballkanasit e tjerë që përpiqen që të gjejnë mbështetje në ndonjë Fuqi të Madhe, shqiptarët sfidojnë Europën dhe Turqinë. Ata, përfundon ai, do të sfidojnë simpatitë dhe miqësinë e botës liberale, ndërkohë që do të shtojnë sikletin e fuqive nënshkruese të Berlinit.³⁸ Por ky pohim i qëndron vetëm pjesërisht të vërtetës. Në fakt, ishte e vërtetë që shqiptarët i sfiduan Fuqitë e Mëdha, pasi qenë të vetmit që arritën t'i ndreqnin vendimet e Kongresit të Berlinit.³⁹ Por nga ana tjetër fuqitë e mëdha i kishin shpërfillur krejtësisht shqiptarët, duke mos shfaqur asnjë lloj simpatie karshi tyre. E vërteta është se përmes kësaj sfide, ata shkelën mësimin kryesor që nxorrën elitat ballkananse nga kriza e vitit 1878, sipas të cilit e vetmja rrugë për zgjerimin tokësor dhe forcimin shtetëror të tyre ishte ajo e gjetjes së një përkrahësi ndër Fuqitë e Mëdha dhe jo ajo e bashkëpunimit me fqinjët.⁴⁰

³⁶ Sipas Kasonit, propozimi që të zgjidheshin dy komandantë në vend të një të vetmi, u bë prej Filip Seismit-Doda, vëllai i një politikani italian që mbante të njëjtin emër, me qëllim që të shmangeshin mosmarrëveshjet fetare.

³⁷ *FRUS 1880-1881...*, vëll. I, f. 57.

³⁸ *Po aty*, f. 57.

³⁹ Misha Glenny, *Histori e Ballkanit, 1804-1999*, Tiranë: "Toena", 2007, f. 153.

⁴⁰ *Po aty*, f. 149.

Kështu shqiptarët u gjetën në fund të këtyre viteve të rrethuar me fqinjë armiqësorë, ndërkohë që asnjë Fuqi e Madhe nuk u zgjati dorën për të mos lejuar mbytjen e aspiratave të tyre kombëtare. Si rrjedhim, atyre s'u ngeli tjetër rrugëzgjdhje, veçse bashkëpunimit me Portën e Lartë.

Por në mbyllje të këtij raporti, Kason njoftonte se sipas lajmeve të fundit që vinin nga Shkodra, lëvizja e fiseve deri më tani nuk është për pavarësi të plotë, por për një principatë autonome nën suzerenitetin e Portës,⁴¹ çka i tregonte zyrtarëve amerikanë të Departamentit të Shtetit se pavarësisht sfidave me të cilat përballëshin, shqiptarët nuk ishin të bashkuar dhe s'kishin një vijë politike të vetme. Këtë përfundim, zyrtarët e Uashingtonit do ta dëgjonin edhe nga goja e Ministrit të Jashtëm austriak.

Pas dështimit të malazezëve për të marrë Hotin dhe Grudën, si pasojë e thyerjes së ushtrive të tyre nga forcat shqiptare të Lidhjes së Prizrenit, fuqitë e mëdha europiane vendosën që t'i dorëzojnë Malit të Zi qytetin shqiptar të Ulqinit. Por këmbëngulja e shqiptarëve për të mos lejuar shkëputjen e asnjë pëllëmbë të trojeve të tyre shkaktoi një krizë të re, e cila u bë sërishmi, një shqetësim për Fuqitë e Mëdha, veçanërisht për ato që kishin interesa të drejtpërdrejta në Ballkan. Kuptohet që ndër to ishte edhe Austro-Hungaria. Në një fjalim të mbajtur në fillim të nëntorit të vitit 1880, Ministri perandorak i Punëve të Jashtme, baroni Haymerle (Hejmerle), ndërsa shtjellonte politikën lindore të Mbretërisë së Dyfishtë, ceku edhe çështjen shqiptare. Pa u ndalur në vijat e politikës së jashtme austriake dhe qëndrimin austriak ndaj çështjes shqiptare dhe dorëzimit të Ulqinit, gjë që kalon përtej qëllimit të këtij shkrimi, interes paraqesin vlerësimet e baronit Hejmerle lidhur me natyrën e nacionalizmit shqiptar dhe përpjekjeve të shqiptarëve për të mbrojtur trojet e tyre, në këtë rast Ulqinin, pasi ato do t'i shërbenin si modele diplomatëve amerikanë dhe vetë Departamentit të Shtetit për të vlerësuar Çështjen Shqiptare dhe për të mbajtur qëndrimin përkatës ndaj saj.

Sipas kreut të diplomacisë austriake, nacionalizmi shqiptar ishte ende në fazë foshnjore dhe kishte për ditëlindja luftën ruso-turke dhe ndryshimet që ajo diktoi në Ballkan. Hejmerle theksonte se vetëm pak vite përpara luftës ruso-turke, vetë shqiptarët dinin shumë pak rreth ndjenjës së tyre kombëtare, lindja së cilës ishte penguar deri atëherë nga dasitë fetare dhe ato krahinore. Shqipëria e Veriut dhe ajo e Jugut, nënvizonte ai, nuk kishin arritur, madje edhe në atë çast, të vendosnin lidhje me njëra-tjetrën në mënyrë që t'i jepnin shprehje ndjenjave për pavarësi ndaj Portës dhe shqiptarët nuk kishin arritur dot të sheshonin pikëpamjet e tyre të kundërta. Sipas tij, organizimi shoqëror fisnor i shqiptarëve e vështirësonte bashkimin, pasi sikurse në çdo shoqëri tribale, fiset, të cilat e përbënin atë, në një çast të dhënë ishin armike dhe në një tjetër ishin aleate. Zyrtari i lartë austriak vinte gjithashtu në dukje edhe dasitë fetare, të

⁴¹ *FRUS 1880-1881...*, vëll. I, f. 57.

cilat edhe pse nuk ishin aq të mprehta si në vendet e tjera të Lindjes, ato prapë se prapë, sipas tij, ekzistonin. Ai vë theksin veçanërisht në faktin se marrëdhëniet mes myslymanëve dhe ortodoksëve, që banonin në jug, ishin më të mira se sa ato që egzistonin mes myslymanëve dhe katolikëve, që banonin në veri.

Baroni Hejmerle i jepte meritë të posaçme Portës për lindjen e një ndjenje kombëtare të shqiptarët, ndjenjë kjo që, sipas tij nuk mund të thuhej se ishte në kundërshtim me interesat e Portës. Por, vazhdonte ai, kjo lëvizje së pari duhej ta bashkonte veten me botën islamike dhe veçanërisht me sulltanin. Ky sugjerim i fundit i ministrit austriak tregon se në vendet perëndimore nuk po kuptonin dot natyrën e nacionalizmit shqiptar. Ky interpretim lidhet njëkohësisht dhe në mënyrë të dyfishtë si me interesin e ministrit austriak për ta interpretuar lëvizjen shqiptare si të integruar brenda botës islamike ashtu edhe me paaftësinë e tij për të kuptuar situatën, shkaqet e qëndresës shqiptare dhe natyrën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në fakt, në kushtet kur shumica e popullsisë shqiptare ka qenë myslymane, atëherë edhe Shqipëria gjykohej si një vend që bënte pjesë në botën islamike. Kjo sillte një varg rrjedhojash mbi mënyrën se si gjykohej dhe vlerësohej populli shqiptar. Kështu, në atë kohë mendohej se në vendet islamike nuk mund të kishte nacionalizëm, pasi nga njëra anë ky i fundit ishte një koncept thellësisht perëndimor dhe nga ana tjetër, në vendet islamike ky koncept ishte i pazbatueshëm, pasi primatin në jetën e tyre e luante feja, e për rrjedhim, në një shoqëri jo të shekullarizuar nacionalizmi nuk mund të zbatohet. Në kushtet kur shqiptarët ishin myslymanë, diplomacia perëndimore nuk e gjykonte lëvizjen e tyre si një lëvizje nacionaliste por si një lëvizje me bazë fetare, e për rrjedhim ata nuk kuptonin se si ishte e mundur që shqiptarët myslymanë të kthenin armët kundër sulltanit, i cili, si kalif, ishte edhe kreu i tyre shpirtëror. Pikërisht, në kushtet e pamundësisë për të kuptuar se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte dhe përfaqësonte një rast të veçantë, si dhe në pamundësi për të kategorizuar këtë lëvizje, atëherë kryediplomati austriak theksonte se kjo lëvizje duhej që të bashkohej me botën islamike dhe Sulltanin. Baroni Hejmerle nuk e shihte lëvizjen shqiptare si një lëvizje nacionaliste që përpiquej të mbronte trojet në të cilat shqiptarët kishin banuar historikisht, por përpiquej ta interpretonte atë si lëvizje të një grupi besimtarësh të çiltër muhamedanë, të cilët ishin rebeluar kundër padishahut për shkak se mendonin se ai kishte tradhtuar fenë islame.

Tezën e fshehjes së Portës së Lartë pas qëndresës shqiptare dhe frymëzimin e saj prej islamizmit, e mohon Ministri amerikan në Stamboll, Heap (Hip), në një raport, që daton në 1 dhjetor të 1880-s, të cilin ai ia dërgon Departamentit të Shtetit, i cili flet për çështjen e Ulqinit. Në këtë raport, me jo pak cinizëm ai njofton dorëzimin e Ulqinit malazezëve duke theksuar se më në

fund, pas katër muaj bisedimesh, ai ‘fshat i panjohur peshkatarësh në Adriatik’, siç e quan Hip, Ulqinin, i cili për një kohë desh çoi Europën në zjarr, iu dorëzua malazezëve. Ai theksonte se ushtria e Vlladikës hyri në qytet me mbështetjen e ushtrisë turke të komanduar nga Dervish pasha.⁴² Zgjidhjen e këtij ngërçi, që ishte bërë një pengesë serioze për t’i dhënë fund Krizës Lindore si dhe një burim sikletesh për fuqitë europiane, ai e komenton si një sukses, pasi nyja shqiptare u çkoklavit pa humbje prestigji. Por, thekson ai, pavarësisht shfaqjes së rreshtimit imponues të fuqisë nga ana e ‘Koncertit të Europës,’ Sulltani e ruajti atë që ai e quante të drejtën e tij dhe nuk pranoi të urdhëronte gjakderdhjen e shtetasve të tij, të cilët i përmbaheshin më me kokëfortësi besëlidhjes së tyre, se sa të kalonin nën sundimin e armikut të tyre historik. Megjithatë, shton Hip, Dervish pasha hasi në qëndresën e shqiptarëve që mbanin qytetin dhe për rrjedhim u detyrua të përdorë forcën, si pasojë e së cilës humbën disa jetë. Zgjidhja e kësaj situatë të vështirë, përmbyll diplomati amerikan, çoi në rritjen e nderit dhe prestigjit, por veçse jo të Europës,⁴³ çka nuk nënkupton as atë të shqiptarëve të cilët ishin viktimat e kësaj lufte për prestigj, por atë të Portës së Lartë.

Por ndërsa në përgjithësi, përpjekjet e shqiptarëve për të mbrojtur trojet në veri të vendit shiheshin me simpati prej diplomatëve amerikanë, kjo nuk ndodhte në rastin e mbrojtjes së trojeve jugore të Shqipërisë. Në dokumentat amerikane, ne ndeshemi menjëherë në një qëndrim prohelan të diplomatëve amerikanë, por jo vetëm. Kështu, Ministri i Jashtëm austriak i kohës do ta cilësonte elementin grek si “një element të lashtë kulture dhe çfarëdolloj kulture” që ishte “shpëtuar në sinujdhesën ballkanike, kjo kishte ndodhur falë qëllimeve të elementit grek”, “qëllimet e të cilit” ishin të shoqëruara nga simpatia e Vjenës.⁴⁴ Në fakt, Greqia dhe gjithçfarë cilësohej prej saj si çështja e vet kombëtare, shiheshin me simpati në mbarë botën perëndimore. Kështu, Greqia e armatosur me mbështetjen ndërkombëtare nuk linte rast pa përdorur për të rrëmbyer çdo territor të mëtuar prej saj. Që pas armëpushimit ruso-osman, në fillim të shkurtit, ndërkohë që palët po bisedonin rreth kushteve të paqes, qeveria greke, sikurse na njofton Ministri amerikan në Athinë, John Meredith Read (Xhon Meredith Rid), dërgoi 10000 trupa në kufirin e saj me provincat osmane të Epirit dhe Thesalisë, me qëllim që ato të mbronin të krishterët në këto dy rajone, jetët e të cilëve, sipas raporteve që lëshonte qeveria greke, kërcënoheshin prej trupave të parregullta turke. Ndërmarrja e një hapi të tillë justifikohet me paaftësinë e trupave osmane për të bërë një gjë të tillë.⁴⁵

⁴² *Po aty*, f. 1175.

⁴³ *Po aty*, f. 1176.

⁴⁴ *Po aty*, f. 24.

⁴⁵ *FRUS 1878-1879...*, vëll. I, f. 365.

Pavarësisht qëndrimit zyrtar të mos përzierjes në çështjet europiane, diplomatët amerikanë e mbështetnin zgjerimin e Greqisë, nisur kjo edhe nga simpatitë personale që ata ushqenin ndaj saj. Kjo duket edhe gjatë vizitës që ish-presidenti Ulisses Grant (Ulisisi Grent), bëri në Greqi në mars të vitit 1878. Në më shumë se një rast ai shprehu mbështetjen që i jepte zgjerimit tokësor të Greqisë. Kështu, në pritjen që i bënë në Athinë ai u shpreh publikisht se uronte “me sinqeritet që Greqia të mund të gëzonte çdo lloj begatie dhe mendoj se ajo duhet të lejohet të marrë atë pozitë të gjerë që i japin asaj qartësisht arritjet e lashta dhe përparimi i sotëm.”⁴⁶ Ndërsa vetë Rid, i raporton Sekretarit të Shtetit, Evarts, se ish-presidenti Grent i ishte shprehur atij se “territoret e pakta të mbretit duhej të zgjeroheshin me territore të konsiderueshme, në mënyrë që Greqisë t’i jepej në botë ai vend që ajo meritonte prej namit të vetë të lashtë dhe luftërave e triumfeve të saja moderne.”⁴⁷ Pavarësisht se mendimet e Grentit nuk peshonin shumë në hartimin e politikës së jashtme amerikane, më tepër kjo për arsye të reputacionit jo të mirë që ai kishte si politikan, që bënte kontrast me atë që ai kishte fituar si ushtarak,⁴⁸ mendimi i tij ka rëndësi për studiuesin sepse ai ishte shprehje e një opinionit që kishte zënë vend të gjerë në zemrat e mjaft amerikanëve dhe perëndimorëve të tjerë që ishin arsimuar me kulturën e lashtë greke.

Në qershor të vitit 1878, Rid njoftonte për zhgënjimin që kishte shkaktuar Kongresi i Berlinit në Greqi. Sipas tij Greqia kishte shterur të gjitha energjitë e saj që të fitonte një vend të respektueshëm, e për rrjedhojë, theksonte ai, ajo gëzonte gjithë të drejtën të besonte së mëtimet e saj të drejta do të pranoheshin. Mospranimi i Greqisë me të drejta të plota përkrah Fuqive të Mëdha europiane në Kongres kishte ngjallur patjetër mjaft shqetësim në radhët e zyrtarëve të lartë grekë. Në të tilla kushte, qeveria greke njoftonte diplomati amerikan nuk kishte më bindjen që çështja e mëtimeve të saj do të zgjidhej me mjete paqësore.⁴⁹ Në të tilla kushte, Greqia ishte duke u përgatitur për çdo rast. Rid arrinte në përfundimin se mund të thuhej fare lirshëm se nëse Kongresi i Berlinit nuk do t’i jepte atë çka ajo me plotë të drejtë kërkonte, dmth. Epirin, Thesalinë, Maqedoninë dhe ishujt e Egjeut, ajo do të bënte luftë “për të marrë çka i përket dhe ndihmuar vëllezërit e saj të shtypur në provincat e sipërpërmendura, edhe duke rrezikuar të humbi ekzistencën e saj.”⁵⁰ Sipas Rid ishte “e pamundur të mos admiroje guximin e grekëve dhe mbretit të tyre...” Për të shtuar simpatinë ndaj çështjes greke në Departamentin e Shtetit, i cili ishte skeptik ndaj të gjitha monarkive, Rid nuk vononte dhe as përtonte të shtonte

⁴⁶ *Po aty*, f. 367.

⁴⁷ *Po aty*, f. 370.

⁴⁸ T. A. Bailey, D. M. Kennedy, *vep. e për.*, f. 453.

⁴⁹ *FRUS 1878-1879...*, vëll. I, f. 375.

⁵⁰ *Po aty*, f. 376.

edhe moton e mbretit grek, që ishte “forca ime është dashuria e popullit tim,”⁵¹ e cila ngjante më shumë me një parullë republikane të kohës se sa me atë të monarkive ballkanase të gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Më 13 qershor, ditën e fundit të Kongresit të Berlinit, në Greqi mbizotëronte ankthi lidhur me vendimet që do të merrte Kongresi i Berlinit mbi mëtimet e shtetit helen. Rid i dërgonte Sekretarit Evarts, një përmbledhje të kërkesave të Athinës zyrtare për zgjerimin e kufijëve të shtetit helen, që u parashtruan prej Ministrisë të Jashtëm grek Delijan, përballë areopagut evropian të Berlinit. Justifikimi që Delijan përdorte për përmbushjen e kërkesave greke ishte se vetëm dorëzimi i provincave të Epirit, Thesalisë dhe Kretës do të vendoste paqen në rajon, dhe kjo ishte edhe në interes të vetë Portës së Lartë, pasi ajo do të humbiste shumë energji për të vendosur paqen në një rajon, i cili nuk pranonte të qëndronte nën sundimin e saj.⁵² Ndërkohë Rid pavarësisht simpatisë së tij për grekët, duke i qëndruar besnik shpirtit të *American businessman*, bëri një vlerësim mbi përfitimet ekonomike që do të kishte Greqia nga përfshirja e këtyre provincave brenda kufijve të saj. Kështu, duke u mbështetur në organin grek të shtypit, *Hora*, ai njoftonte se Greqisë do t'i shtohet një popullsi prej 600000 mijë banorësh me të ardhura prej 17.000.000 dhrahmish, që donte të thoshte se popullsia e Greqisë do të shtohet me një të tretën e saj ndërsa të ardhurat do të shtoheshin me 50 përqind.⁵³ Pra nga këto të dhëna del qartë se sa të pasura kanë qenë rajonet e Thesalisë dhe Epirit në krahasim me krahinat që ndodheshin brenda shtetit grek. Shifrat dëshmojnë se popullsia e këtyre provincave ka gëzuar një mirëqënie më të madhe se sa popullsia e vetë Greqisë së kohës, duke na nxjerrë kështu edhe një nga arsyet që kanë shtyrë shtetin grek të luftonte për aneksimin e tyre.

Por Traktati i Berlinit nuk i dha grekëve atë që pritnin dhe e vetmja gjë që u vendos në protokollin XIII ishte që të ngarkuarit otoman dhe ata grek të takoheshin dhe të vendosnin për ndryshimin e kufijve në Thesali dhe Epir.⁵⁴ Ky vendim i Kongresit, i cili nuk u miratua prej palës osmane, u ndoq nga një letër notë që Veziri i Madh, Safet pasha, bëri mbi mëtimet greke ndaj trevave që ndodheshin në sundimin osman. Në këtë notë ai hedh poshtë këto mëtime dhe padit shtetin grek si nxitës i të gjitha trazirave që ndodhnin në këto provinca. Këtu veç të tjerash ai hedh poshtë pretendimin helen se kryengritja e bërë në vitin 1845 në Shqipërinë e poshtme ishte një lëvizje e kryer prej të krishterëve të këtij rajoni, të cilët kërkonin shpëtimin e Epirit prej Perandorisë Osmane. Safet pasha thekson se kjo kryengritje ishte kryer prej shqiptarëve myslymanë, që kishin kërkesa krejt të tjera nga ato që mëtonin grekët. Sipas kreut të

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, f. 377.

⁵³ *Po aty*, f. 378.

⁵⁴ *Po aty*, f. 891.

qeverisë osmane, në vitin 1878, banda të organizuara prej shtetit grek kapërcyen kufirin dhe u përpoqën përmes shpatës dhe zjarrit të hidhnin popullsinë e këtyre dy rajoneve kundër sundimitarit të tyre të ligjshëm, gjë të cilën ata nuk e bënë dot si pasojë e “urtësisë dhe besnikërisë së të gjithë popullatës.”⁵⁵ Por këtë herë, Safet pasha nuk paraqet elementin shqiptar si bërthamën kryesore të qëndresës antigreke, të paktën në Epir, gjë që e bënin jo vetëm si myslyman por edhe si shqiptar, e që ishin të organizuar në këtë veprimtari edhe prej Lidhjes së Prizrenit. Në fakt shtetarit të lartë turk nuk i leverdiste që këtë radhë të fliste me emra të përveçëm kombëtarë, por përkundrazi, kishte interes që ta paraqiste këtë lëvizje si një veprim shtetasish besnik të Sulltanit, që i shërbenin atij me përkushtim. Por diplomacia amerikane, ashtu sikurse e pamë edhe më sipër, i kishte të dhënat që shqiptarët po vepronin sipas një programi të tyrin kombëtar për mbrojtjen e trojeve të veta, duke i’u kundërvënë me armë si Malit të Zi dhe Greqisë, ashtu edhe Portës së Lartë kur panë se ajo po vepronte kundër interesave të tyre kombëtare. Ky fakt i bashkuar edhe me mosdëshirën e Portës për t’i dorëzuar Greqisë trojet e Shqipërisë së Jugut, çuan në zvarritjen e zgjidhjes së çështjes së kufirit greko-osman.

Sikurse edhe mund të parashikohej lehtë, vendimi i Kongresit të Berlinit, që kufiri osmano-grek të rregullohej mes palëve, i dha mundësinë osmanëve që ta zvarrisnin çështjen pafund. Por kjo zvarritje nuk kaloi e pavëzhguar prej Fuqive të Mëdha, veçanërisht pas ndërrimit të qeverive në Britani në vitin 1880. Sikurse raporton Ministri amerikan në Berlin, White (Uajt), me ardhjen në pushtet të Gladstonit, ky nisi një politikë të vendosur antiosmane. Menjëherë Fuqitë e Mëdha kërcënuan Portën e Lartë që ajo t’i jepte fund zvarritjeve dhe të shpejtonte vendosjen e kufirit, përndryshe ato do humbnin dashamirësinë e tyre karshi Sulltanit.⁵⁶ Pasi informon Departamentin e Shtetit mbi kufijtë që mund të përvetësoheshin prej Greqisë, Uajt, njoftonte se popullsia që banonte rajonin në fjalë ishte rreth 300000 banorë, nga të cilët një e treta i përkitnin besimit muhamedan dhe pjesa tjetër ishin grekë të krishterë.⁵⁷ Pa dashur të debatohet mbi vërtetësinë e shifrave, gjë që nuk përbën qëllimin e kësaj teme, ajo që të bie në sy është fakti se diplomatët amerikanë shpesh kur flasin për popullsinë shqiptare që i kalonte apo duhej t’i kalonte vendeve fqinje, e përmendin atë duke e identifikuar përmes fesë dhe jo përmes etnisë. Rasti i mësipërm nuk është i vetmi. Kështu, në një rast tjetër, Ministri amerikan në Vjenë, Kason, i cili, ashtu sikurse pamë edhe më sipër ishte një njohës i mirë i situatës në Shqipëri, kur flet për popullsinë shqiptare të aneksuara nga Mali i Zi, i përmend ata duke marrë si mjet identifikimi përkatësinë e tyre fetare, duke i cilësuar si

⁵⁵ *Po aty*, f. 893.

⁵⁶ *FRUS 1880-1881...*, vëll. I, f. 438.

⁵⁷ *Po aty*, f. 440.

myslymanë apo muhamedanë dhe jo si shqiptarë.⁵⁸ Pra nga ajo që shihet diplomatët amerikanë kur vinte puna për shqiptarët që kalonin nën sovranitetin e shteteve ballkanike, i identifikonin ata sipas mënyrës që i identifikonin këto shtete, gjë që ato e bënin sepse njohja sipas përkatësisë fetare i leverdiste më shumë se sa njohja sipas përkatësisë kombëtare. Ndërkaq, kjo nuk ndodhte për shqiptarët që ndodheshin në provincat osmane, të cilët identifikoheshin prej tyre si shqiptarë. Pra në çastin që shqiptarët përfshiheshin brenda shtet-kombeve klasike ballkanike, ata identifikoheshin si pakica fetare, ndërsa në Perandorinë Osmane, që ishte një shtet i deklaruar shumëkombësh, i cili vazhdonte t'ia nënshtronte popullsisë së vet, ndarjes dhe mënyrës mesjetare të identifikimit sipas përkatësisë fetare, shqiptarët identifikoheshin përmes emërimit etnik. Kjo duket paksa e çuditshme, pasi duket sikur mënyra e identifikimit ka ndërruar vend. Si duket përfaqësuesit diplomatik amerikanë, duke e njohur ndjeshmërinë e vendeve ballkanike ndaj çështjeve të tyre kombëtare, kur vinte puna për pakicat kombëtare brenda këtyre vendeve, tregoheshin të kujdesshëm dhe përdornin leksikun e këtyre të fundit në emërtimin identifikues të këtyre pakicave. Ky presion, i cili do të bëhej i fuqishëm vetëm tridhjetë vjet më vonë, nuk ekzistonte ende në Perandorinë Osmane.

Shqiptarët do të përmendeshin për herë të fundit në dokumentat amerikane të këtyre viteve, në një raport të 14 majit të 1881-it, që Ministri amerikan në Stamboll, Hip, i dërgonte Departamentin e Shtetit. Aty Hip raportonte shkurtimisht në një fjali të vetme mbi ato çka po ngjanin në veri dhe jug të trevave të banuara nga shqiptarët. Ai shkruante se kryengritja në Shqipëri kishte përhapur turbullirë në çdo drejtim dhe tekta e hidhte vështrimin e tij më pas drejt jugut, theksonte se atje ekzistonte një gjendje anarkie, e cila nuk do të pushonte deri sa të zgjidhej çështja e trevave që duhej t'i kalonin Greqisë dhe këto territore të aneksoheshin dhe pushtoheshin prej saj.⁵⁹ Ishte fjala për shtypjen që ushtritë turke i bënë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila, tashmë, pas zgjidhjes së problemit të kufijve turko-malazez nuk përbënte më një shqetësim për Europën dhe për rrjedhim fati i shqiptarëve kalonte vetëm në një gjysëm fjalie. Përsa i përket pjesës së dytë të fjalisë që cekte edhe çështjen shqiptare, ajo nuk ka nevojë për komente. Me kaq mbyllet odiseja e shkurtër e shqiptarëve në dokumentat amerikane të këtyre viteve. Ata do të ridilnin në skenë vetëm shumë vite më vonë.

⁵⁸ *Po aty*, f. 61.

⁵⁹ *Po aty*.

S u m m a r y

“THE LEAGUE OF PRIZREN AND THE ALBANIAN ISSUE DURING
1978-1881 THROUGH THE AMERICAN DOCUMENTS”

The American documentary sources briefly mention the developments in Albanian during 1878-1881. However, they help us to understand in a more complete manner the historical process of the League of Prizren. On the other hand the fact that Albania is mentioned in these documents is of certain significance. A far away country such as USA had no immediate interests in Albania and beside all had developed an isolationist policy toward Europe as well as had demonstrated a total disinterest toward the developments in Near East. Therefore the mentioning of the Albania issue from the American diplomats in their reports for Washington it is an indirect indicator to the fame of the events that took place during that time in Albania and not the small troubles caused by the Albanian resistance to the decisions taken by the Concert of Europe. The documents have certain value in order to understand the manner in which Albanians are seen and how their demands were interpreted, something that makes us understand the level of development in which was the Albanian National Movement. The American diplomats by living in the Old Continent took the experiences and the viewpoints of these countries and were influenced in this manner by the public opinion and the interests of the government staff where they served. However, they had as well their own independent opinions, they were Americans, bearers of the values of the country from which they where coming from. Here appears another value of these documents. They present to us the American viewpoint toward the national movements that during that period were boiling over in Europe. Nevertheless often were influenced negatively due to the lack of knowledge toward Albania, which was distant not only for them but also for the great majority of the Europeans. In this manner they would be influenced easily due to the personal sympathies nurtured for different populations of the region. This was a great deal of time before Albanians and their demands would be heard well and be understood in a clear way in Washington.

